REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 146/17
Datë/Datum. 29.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Prishtinë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **146/17** e OE **"New Line"** - Prishtinë.		
Datë:	29.05.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftoj me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 18.05.2017 me Nr. 146/17 nga OE **"New Line"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës: **"Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës së Institucioneve parashkollore në Prishtinë"**, me numër të prokurimit: PR616/16/169/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prishtinë.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA PRISHTINË**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **NEW LINE.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		24.05.2017		**24.05.2017**		**29.05.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 18.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **146/17** e parashtruar nga OE **"New Line"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës së Institucioneve parashkollore në Prishtinë"**, me numër të prokurimit: PR616/16/169/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prishtinë.** Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Prishtinës (KP).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "New Line", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"New Line"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës;
Rregullat për çmime Jo-Normalisht të ulëta.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

AK: me datë 16.01.2017, përmes shkresës elektronike ka kërkuar nga OE sqarime shtesë lidhur me artikullin numër 47 (mish viç i freskët), duke cilësuar çmimin e këtij artikulli si çmim jo-normalisht i ulët.

Përgjigjja e OE:

Pas kësaj kërkese kompania jonë ka kontrolluar listën e çmimores dhe ka gjetur se gjatë vendosjes së çmimeve, ka ndodhë një gabim teknik (në vend se çmimi të vendoset 7.00 euro është vendosur 0.70 euro). Pas analizimit të ofertës tonë financiare kemi ardhur në përfundim se edhe pse kemi humbje në artikullin nr 47, artikujt tjerë janë me fitim dhe në total kompania gjeneron fitim nga furnizimet e këtij projekti.

Kërkesa shtesë nga AK:

Pas sqarimit tonë lidhur me çështjen e ngritur nga AK, i njëjti nuk është bindur me sqarimin e OE dhe përmes shkresës elektronike të datës 17.01.2017 ka kërkuar dëshmi tjera më bindëse për t'u siguruar se OE ka kapacitete të mjaftueshme për të ekzekutuar këtë projekt.

Përgjigjja e OE:

Kompania jonë i është përgjigjur AK duke thënë, se ne jemi të gatshëm që përpos vlerës obligative të sigurimit të ekzekutimit (10 % të vlerës së kontratës me kohëzgjatje 13 muaj), ta pranojmë një rritje

të përqindjes së sigurimit të ekzekutimit si vlerësimit të AK-së.

Kerkesa e AK:

AK ka kërkuar që sigurimi i ekzekutimit të tenderit te jetë në vlerë prej 20 % të shumës totale vjetor të kontratës me kohëzgjatje 13 muaj. Kompania jonë duke qenë e bindur se ka kapacitete dhe përfitim ekonomik në këtë projekt, ka pranuar kërkesën e AK, si dhe ka dorëzuar polisen e sigurimit të ekzekutimit të tenderit në vlerë prej 20 % të shumës totale të kontratës në kohëzgjatje prej 13 muajve. Duke u bazuar në vlerësimin paraprak të AK, mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP - së si dhe vendimit e panelit shqyrtues të OSHP-së, vendim ky i cili ka kërkuar nga AK që lënda të kthehet në rivlerësim, ky rivlerësim të bëhet duke u bazuar në nenin 61 të LPP-së, duke respektuar nenin 4 paragrafi 4.4 dhe paragrafi 4.6 të rregullores B57, kompania jonë konstaton si në vijim:

Vendimi i Panelit të OSHP - së tregon udhëzime për AK që gjatë rivlerësimit të bazohet në nenin 61 të LPP -së, duke respektuar nenin 4 paragrafi 44 dhe paragrafi 4,6 të rregullores B57.

Neni 4

Procedura e Shqyrtimit (inter partes)

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim ne Nenin 61 te LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoi tenderin veçanërisht të

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoi me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa Standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

4.3 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo,

tenderi do të refuzohet.

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet. Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4. 4.1 ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit:

4. 4.2 Çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur:

4.4.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar dhe/ose

4. 4.4 Origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

4.5 Përveç elementeve te tenderit te përcaktuara ne nenin 4.4 te këtyre rregullave, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4.5. I elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrimi nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose

4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoi tenderin njëjtë me tenderët tjerë.

ose

4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoi tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoi KRPP, duke përdorur formëri standarde të miratuar nga KRPP. "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.

AK në vlerësimin e parë ka respektuar plotësisht nenin 4 të rregullores B57 duke kërkuar me shkrim nga OE dëshmi shtesë për artikullin abnormalisht të ulët, OE i është përgjigjur kërkesës së AK duke deklaruar se është i gatshëm të furnizoj me këtë çmim, në mënyrë qe deklarata e OE të jetë më bindës AK ka kërkuar që të rritet vlera e sigurimit të ekzekutimit të tenderit nga 10 % sa ka qenë në dosjen e tenderit në 20 % me kohëzgjatje 13 muajve. OE është pajtuar me këtë kërkesë dhe ka dorëzuar polisen e sigurimit sipas kërkesës së AK-sé. Ndërsa AK në rivlerësim nuk ka marrë për bazë dëshmitë shtesë të dorëzuara nga OE (sigurimi i ekzekutimit të tenderit në vlerë prej 20 % të shumës së kontratës), dëshmi këto të cilat kanë qenë të përcaktuara nga vet AK dhe janë konsideruar si dëshmi të mjaftueshme për realizimin e kësaj kontrate.

Përfundim:

Kompania jonë kërkon nga AK që të behet rishqyrtimi i këtij aktiviteti te prokurimit dhe rivlerësimi të behet duke u bazuar si në vijim:

- Vendimin i OSHP-së që tregon se rivlerësimi duhet të bëhet konform nenit 61 të LPP-së, duke respektuar nenin 4 paragrafi 4.4 dhe paragrafi 4.6 të rregullores B57.
- Mendimin e Ekspertit shqyrtues
- Vlerësimin paraprak te AK Dëshmitë e dorëzuara nga OE për ekzekutimin e këtij projekti.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 30.11.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizim/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 27.12.2016

Data e hapjes së ofertave .....27.12.2016-14:30^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 12 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, me kerkesat e nenit 65 .

Dëshmitë dokumentare:

1.Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi (duhet dorëzuar së bashku me tenderin).

Dëshmitë tjera lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d,e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit- Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike-për tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës.

b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] – Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dështmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

1.Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Kopja e çertifikates se regjistrimit të biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar-

Qarkullimi financiar në tri vitet e fundit(2013,2014 dhe 2015) te jete se paku 300.000,00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Konfirmimin nga banka për qarkullimin e kërkuar ose Deklaratat vjetore tatimore te dorezuara ne ATK.

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional-

1.OE duhet te këtë kryer furnizime te ngjashme ne tri vitet e fundit(2013,2014 dhe 2015) deri ne shume prej 300,000.00€

Dëshmia e kërkuar dokumentuese:

1.Listën e furnizimeve kryesore dhe relevante të realizuara në 3 vitet e fundit, duke saktësuar:

-furnizimet e përfshira,

-dëshmitë-certifikatat, referencat apo kontratat për furnizimet e realizuara.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Mendi Trade"	Prishtinë	37,818.05€	JO
3.	"Meteor"	Prishtinë	24,753.91€	JO
4.	"Florenti"	Mitrovicë	27,331.00€	JO
5.	"Beni Dona"	Prishtinë	25,061.50€	JO
6.	"Hajdini Comerce"	Prishtinë	21,865.50€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Nexhmi Mekolli - Kryetar i komisionit
- Arbër Gashi - Anëtar i komisionit
- Arlinda Cakiqi - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 18.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....18.04.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....18.04.2016

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	**Mendi Trade**	**37,818.05€**	**5**
3.	**Meteor**	**24,753.91€**	**2**
4.	**Florenti**	**27,331.00€**	**4**
5.	**Beni Dona**	**25,061.50€**	**3**
6.	**Hajdini Comerce**	**21,865.50€**	**1**

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i Ri-vlerësimit te ofertave për tenderin "Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës së Institucioneve parashkollore në Prishtinë", duke u bazuar ne vendimin e PSH nr. 56/17 dhe duke vërtetuar se OE "New Line&Bajraktari", i cili ka ofertuar me çmimin me te lire te ofertës ka dhënë çmime Jo-Normalisht te ulëta ne disa artikuj, andaj komisioni vendosi qe për kontratë ta propozoj OE tjetër me radhë: OE "Hajdini Comerce", me vlerë te ofertës prej: 21,865.50€.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar. Duhet sqaruar se OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim brenda afatit te parapare ne nenin 108/A, ndërsa AK-Komuna e Prishtinës nuk e respektuar ne tërësi nenin 108.4 te LPP-se, për faktin se nuk i ka kthyer përgjigje OE ankues brenda afatit te parapare ne nenin e lartpërmendur, duke e arsyetuar me ngarkesë ne pune.
Eksperti shqyrtues vlerëson se edhe pse vendimi i AK-se është vonuar OE ankues nuk e ka humbur afatin për parashtrim te ankesës sepse sipas nenit 108 te LPP-se, ne momentin e parashtrimit te kërkesës për rishqyrtim pran AK-se, pezullohet automatikisht aktiviteti i prokurimit te cilin AK-ja e ka pezulluar me vendim.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se pas vendimit te panelit shqyrtues, me nr 56/17 te datës: 05.04.2017, AK-ja e kthyer ne Ri-vlerësim këtë aktivitet te prokurimit, konform vendimit te lartpërmendur.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, pasi i ka analizuar shkresat e lendes sqaron se AK-ja, gjate Ri-vlerësimit te ofertave gjegjësisht paramasës dhe parallogarisë se OE ankues "New Line", nuk është bindur me çmimet e dhëna nga OE ankues. Me saktësisht OE ankues përveç pozicioneve tjera, ne pozicionin nr. 47 te paramasës – Mish Vici i freskët/kg, ka dhënë çmim prej 0.70 euro/cent.

Eksperti shqyrtues, sqaron se gjate Ri-vlerësimit AK-ja i ka analizuar edhe njëherë shkresat e lendes, dhe përkundër sqarimeve te dhëna nga OE ankues (sqarimet te cilat AK-ja i ka kërkuar herën e pare, ndërsa pas vendimi te PSH-se, nuk ka kërkuar sqarime, me arsyetimin se kanë qene te mjaftueshme), i cili ka deklaruar se jemi te gatshëm qe te pranojmë edhe rritjen e sigurisë se ekzekutimit, AK-ja nuk është bindur për faktin se çmimi prej 0.70 euro/cent është Jo-Normalisht i ulet.

Ne lidhje me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se konform nenit 61.4 te LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejt e Autoritetit Kontraktues, andaj, ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm dhe njëherit eksperti shqyrtues, sqaron se edhe vet OE ankues ne aneksen e tij e pranon se ka ofruar çmim prej 0.70 euro/cent, për te cilin deklarohet se kemi humbje ne këtë produkt mirëpo mbulohet nga artikujt tjerë qe janë me fitim.

Sqarimi nr.3

Poashtu ne lidhje me pretendimin e OE ankues se AK-ja, ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-se, eksperti shqyrtues, sqaron se ne shkresat e lendes nuk ka vërejtur diskriminim apo trajtim te pa barabartë te OE-ve, ne këtë aktivitet te prokurimit.
Eksperti shqyrtues, siç e ka përmendur edhe me lart sqaron se sipas nenit 61 te LPP-se, është e drejt e AK-se vlerësimi i çmimeve te ofruara nga OE-te, dhe nga provat e dëshmuara nga OE ankues, AK-ja nuk është bindur me çmimin e artikullit nr. 47 te paramasës se OE ankues "New Line".
Eksperti shqyrtues e vlerëson ankesën e OE ankues si pjesërisht te bazuar për faktin se AK-ja, nuk e ka respektuar ne tërësi nenin 108/A te LPP-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Prishtinë**, për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me artikuj ushqimor për nevojat e kuzhinës së Institucioneve parashkollore në Prishtinë"**, me numër të prokurimit: PR616/16/169/111, i ka respektuar dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe njëherit propozon që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar.